

# **RAPORT I AUDITIT TE PAVARUR**

**DHE**

**PASQYRAT E FONDEVE TE PERFITUARA DHE SHPENZIMEVE TE KRYERA  
GJATE FUSHATES ZGJEDHORE PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE PER  
PERIUDHEN**

**21 MAJ 2015 - 21 QERSHOR 2015**

**SUBJEKTI**

***PARTIA ORA E SHQIPERISE***

**Tirane, 13.10.2015**

**Lumturi BRAHAJ**

Eksperte Kontabel e Autorizuar

Rr. Asim Vogshi, Pallati 13 katesh,shkalla nr.25 ,ap.6

**Tel ++ 355 4 2403 910 cel. 069.21.58.344, 069.20.69.881**

## **PERMBLEDHJE**

---

### **1 Raporti i audituesit te pavarur per**

#### **PARTINE ”PARTIA ORA ESHQIPERISE”**

( Nga faqia 1 e 3-4)

Pasqyra e fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera gjate fushates per zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore te dates 21 Qershor 2015.(faqia 5)

Shenime per pasqyren financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, gjate fushates per zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore te 21 Qershor 2015te renditura si me poshte:(Nga faqia 6-9)

<b>I</b>	Te pergjithshme	<b>6</b>
<b>II</b>	Politikat operuese	<b>6</b>
<b>III</b>	Rregullat e vleresimit	<b>7</b>
<b>1</b>	Fondet e perfituara gjate fushates zgjedhore 2015	<b>8</b>
<b>2</b>	Shpenzimet e kryera gjate fushates zgjedhore 2015	<b>8</b>
<b>3</b>	Likuiditetet	<b>8</b>
<b>4</b>	Kreditore te palikujduar	<b>9</b>
<b>5</b>	Dokumentacioni dhe rregjistrimi i fondeve jopublike	<b>9</b>
<b>6</b>	Ngjarje te me vonshme	<b>9</b>

# **RAPORT I AUDITIT TE PAVARUR MBI ANGAZHIMET E AUDITIMIT PER QELLIME TE VECANTA**

Drejtuar :

Komisionit Qendror te Zgjedhjeve:

Pallati i Kongreseve ,

Tirane Albania

Tirane , me 13 Tetor 2015.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkelidhur te fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera nga "Partia Ora e Shqiperise (e quajtur me tej "Organizate Politike") per periudhen 21 Maj 2015 deri me 21 Qershor 2015.

## **Pergjegjësia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare**

Drejtimi mban pergjegjesi per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave ne perputhje me Ligjin Nr. 10019, date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise" dhe Ligjin Nr.9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" date 29.04.2004. Kjo pergjegjesi perfshin: dokumentacionin mbartes te fondeve dhe shpenzimeve te kryera, politiken kontabel te ndjekur per hartimin e pasqyrave financiare per fondet e perfituara dhe shpenzimeve te realizuara per fushaten zgjedhore, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen e pasqyrave financiare qe mos permbajne anomali dhe gabime materiale. Mbi kete baze, fondet e perfituara njihen kur fitohen ne lek ose ne materiale dhe sherbime te konvertuara dhe shpenzimet njihen si te tilla ne momentin qe ato jane kryer dhe jo kur ato paguhen.

## **Pergjegjësia e Audituesit**

Pergjegjësia e jone eshte qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat e etikes dhe qe te planifikohet dhe te kryhet auditimi per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali dhe gabime materiale.

Nje auditim perfshin kryerjen e procedurave, mbi bazen e testeve, te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare. Keto procedura te cilat zgjidhen ne varesi te gjykimit te audituesit, perfshijne vleresimin e rrezikut te gabimeve materiale te pasqyrave financiare, qe mund te kene ndodhur per shkak te mashtrimit ose te gabimeve. Per realizimin e vleresimit te ketyre rreziqeve, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare me qellimin qe te hartojte procedura te auditimit te pershtatshme sipas situates, por jo me qellimin e shprehjes se nje opinionit ne lidhje me efektivitetin e kontrollit te brendshem te subjektit. Nje auditim perfshin vleresimin e pershtatshmerise te politikave kontabel te perdoruara dhe arsyeshmerine e vleresimeve kontabel te bera nga drejtimi si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme qe evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per tu perdorur si baze ne dhenien e opinionit tone te audituesit.

*Opinion*

Sipas opinionit tone, pasqyrat bashkalidhur , te marra ne teresi dhe ne te gjithe aspektet materiale, japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te fondeve te perfituara dhe te shpenzimeve te kryera nga Partia Ora e Shqiperise per fushaten zgjedhore ne periudhen 21 Maj 2015 deri ne 21 Qershor 2015, ne perputhje me kohen e perfitimit dhe kryerjes se shpenzimit, ne pajtim me ligjin 10019, date 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise dhe ligjin Nr.9228, date 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.



**Lumturi BRAHAJ**

Eksperte Kontabel e Autorizuar

Rr. Asim Vogshi, Pallati 13 katesh, shkalla nr.25 ,ap.6

Tel ++ 355 4 2403 910 cel. 069.21.58.344, 069.20.69.881

## PARTIA ORA ESHQIPERISE

### PASQYRA E FONDEVE TE PERFITUARA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2015

NR	Burimet e te ardhurave per Zgjedjet vendore te 21 Qershor 2015	Shenime	Vendi i depozi-timit	Lloji monedhes			Kursi	Totali ne Leke
				Leke	USD	Ne Natyre		
I	Buxheti i shtetit	1	Banka	83,3333	-	-	1	83,3333
II	Burimet e veta	2	Banka	0	-	-		0
III	Dhurime,donacione	3		0	-	-		0
	Dhurime	3.1	Banka	0	-	-		0
	Dhurime	3.2	Arka	0	-	-		0
IV	Te ardhura nga kuotat	4	Arka	0	-	-		0
IV	Interesa bankare	5	Banka	0		-		0
	<b>TOTAL P.0.SHQIPERISE</b>			<b>83,333</b>				<b>83,333</b>

### PERDORIMI I FONDEVE TE PERFITUARA PER ZGJEDHJET Vendore te 2015

NR	Emertimi i shpenzimeve	Shenime	Menyra e kryerjes se pageses	Nga POSH. Selia qendrore	Shpenzime te pa paguara	Totali i Shpenzim
1	Komisione bankare	<b>a</b>	Banke	3,833	0	3,833
2	Postera,kartvizita,fotografi e tjer	<b>b</b>	Arke	29,500	0	29,500
3	Te tjera udhtim djet ushqim,karburant	<b>c</b>	Arke	50,000	0	50,000
	Totali shpenzimeve			83,333	0	83,333

## **INFORMACIONE TE PERGJITHSHME**

### **1. OBJEKTI I AUDITIMIT**

Fondet publike dhe jo publike te perfituara dhe te shpenzuara nga subjekti per fushaten zgjedhore per Zgjedhjet e Organeve te qeverisjes Vendore te dates 21 Qershor 2015.

### **2. SUBJEKTI I AUDITIMIT**

Subjekti **Partia “ORA E SHQIPERISE**, per Zgjedhjet per Zgjedhjet e Organeve te Qeverisjes Vendore te dates 21 Qershor 2015.

### **3. INFORMACION MBI AUDITIMIN**

a) **Partia ORA E SHQIPERISE** eshte organizat politike e regjistruar ne Gjykat me vendimin nr 8379 date 23.11.2007.

**Ajo eshte e regjistruar ne organet tatimore me NIPT- K 91815451 D.**

b) Auditimi eshte mbeshtetur ne dokumentacionin financiar te kesaj periudhe per periudhen (Maj-Qershor 2015).

Auditimi eshte mbeshtetur ne kerkesat e Ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor I Republikes se SHqiperise” i ndryshuar.

### **4. PERIUDHA E AUDITIMIT**

Shtator -Tetor 2015

### **5. PERSONAT E KONTAKTUAR**

**Kryetari Partise dhe financier saj.**

## **ANEKSI I DYTE**

### **ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR**

#### **1. Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet publike**

Ne Ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor I Republikes se SHqiperise” i ndryshuar, Neni 87 “Shpërndarja dhe rishpërndarja e fondeve publike për subjektet zgjedhore” pika 2 shpreh “ Sasia e fondeve publike që i shpërndahet secilit prej subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të KQZ-së, sipas rregullave të mëposhtme”

Ne Lidhje me sa me siper *Konstatoj* se :

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti ka qene perfitues i fondeve publike per Zgjedhjet per Zgjedhjet e Organeve te qeverisjes Vendore te dates 21 Qershor 2015 ne masen 83 333 leke te cilat jane derdhur nga thesari ne llogarine bankare ne Raiffezen Bank.

## **2. Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jo publike.**

Ne Ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor I Republikës së SHqipërisë” i ndryshuar , Neni 89 “Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike” dhe Neni 90 “Regjistrimi i fondeve jopublike” *konstatohet se:*

### **Neni 89 pika 1 shpreh:**

Subjektet zgjedhore mund të marrin, për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore, fonde vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Për qëllim të këtij Kodi, konsiderohet person fizik vendas edhe shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti nuk ka qene perfitues i asnje fondi per qellime te fushates zgjedhore nga persona fizike apo juridike vendas kjo sipas deklarimit te perfaqesuesit si dhe te regjistrimit te dhurimeve apo prej historikut te llogarise bankare.

### **Neni 89 pika 2 shpreh:**

Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t’i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlefata në sende ose shërbime.

*Konstatohet:*

Subjekti nuk ka qene perfitues i asnje fondi per qellime te fushates zgjedhore nga persona fizike apo juridike vendas.

### **Neni 89 pika 3 shpreh:**

Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

- a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë;
- b) ushtron veprimtari në fushën e medias;
- c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;
- ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.

*Konstatohet:*

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti nuk ka qene perfitues i asnje fondi per qellime te fushates zgjedhore nga persona fizike apo juridike vendas i cili ndodhet ne kushtet e mesiperme.

### **Neni 90 pika 1 shpreh:**

Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 89 të këtij Kodi dhe mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për t’u nënshkruar në çdo rast dhurimi. Lista e personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse duhet të bëhen kurdoherë publike.

*Konstatohet:*

Nga verifikimet e kryera rezulton se ne perputhje me kete nen, subjekti zgjedhor ka

mbajtur regjister te posaçem sipas modelit te miratuar nga KQZ-ja.

**Neni 90 pika 2 shpreh:**

Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor, jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

*Konstatoj:*

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti nuk kishte i nje llogarie te vecante per fonde per qellim te fushates zgjedhore.

**Neni 90 pika 3 shpreh:**

Shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 87 të këtij Kodi. Çdo shpenzim i kryer për fushatën zgjedhore dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.

*Konstatoj:*

- Subjekti ka perfituar fonde publike dhe per rrjedhoje shpenzimet e kryera mund ti nenshtrohen krahasimit ne perputhje me piken 3 te nenit 90.
- Shpenzimet e kryera jane ne perputhje me Kodin Zgjedhor.

**Fondet e perfituara e te shpenzuara pasqyrohen ne pasqyrat e me poshteme:**

**PASQYRA E FONDEVE TE PERFITUARA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2015**

NR	Burimet e te ardhurave per Zgjedjet vendore te 21 Qershor 2015	Shenime	Vendi i depozi-timit	Lloji monedhes			Kursi	Totali ne Leke
				Leke	USD	Ne Natyre		
I	Buxheti i shtetit	1	Banka	83,3333	-	-	1	83,3333
II	Burimet e veta	2	Banka	0	-	-		0
III	Dhurime,donacione	3		0	-	-		0
	Dhurime	3.1	Banka	0	-	-		0
	Dhurime	3.2	Arka	0	-	-		0
IV	Te ardhura nga kuotat	4	Arka	0	-	-		0
IV	Interesa bankare	5	Banka	0		-		0
	<b>TOTAL P.O.SHQIPERISE</b>			<b>83,333</b>				<b>83,333</b>

**1-Te vetmet te ardhura qe ka patur Partia Ora e Shqiperise kane qene fondi i dhene nga buxheti shtetit i cili eshte depozituar ne llogarin bankare ne Raiffezen banke gjitesej jane 83,333 leke.**

**2-Burime te veta gjendje nuk ka patur ose gjendja ne fillim e ne fund te fushates ka qene zero.**

**3-Nuk kishte anje dhurim apo donaciondhe as dokumenta qe te vertetonin dhurimet.**



4-Nuk kishte asnje te ardhur nga kuotat e antarsis te depozituar ne banke ose ne arke.

5- Nuk ka perfituar asnje interes bankare mbasi gjendja e llogaris bankare ka qene zero dhe me ardhjen e fondit nga thesari i jane zbritur komisionet bankare per mbajtjen e llogaris.

#### PERDORIMI I FONDEVE TE PERFITUARA PER ZGJEDHJET Vendore te 2015

### 2.1 Shpenzimet e kryera nga Selia Qendrore e P.O.SH

NR	Emertimi i shpenzimeve	Shenime	Menyra e kryerjes se pageses	Nga POSH. Selia qendrore	Shpenzime te pa paguara	Totali i Shpenzim
1	Komisione bankare	a	Banke	3,833	0	3,833
2	Postera,kartvizita,fotografi e tjer	b	Arke	29,500	0	29,500
3	Te tjera udhtim djet ushqim,karburant	c	Arke	50,000	0	50,000
	Totali shpenzimeve			83,333	0	83,333

- Komisionet per mbajtje llogari bankare jane 3,833 leke ,te cilat jane mbajtur nga banka ne momentit qe kan kaluar leket ne llogari nga thesari.**
- Shpenzime per postera kartvizita fotografi e te jera te ngjashme jane 29,500 leke te cilat u jane dhene nga arka organizatorve te fushates zgjedhore.**
- Po keshtu per te perballuar shpenzimet e fushates orgaizatorve ju jane dhene 50 000 leke nga arka me mandat pagese.Keto shpenzime jane bere per udhetimin,karburantin dhe ushqimin e tyre.**

Auditimi lidhur me shpenzimet e mesiperme u krye ne zbatim te kerkesave te Standarteve Nderkombetare te Auditimit (SNA), duke verifikuar dhe duke testuar vertetesine e tyre me kontrollin e mbi 1/4 e dokumentacionit mbartes te furniturav dhe sherbimeve te mesiperme. Nga ky proces kontrolli e verifikimi, u arrit nje besueshmeri e pranueshme mbi vlefshmerine e ketyre shpenzimeve te kryera e te likujduara.

Gjendja e likujditetit ne fund te fushates zgjedhore eshte zero.

Ngjarje te me vonshme nuk ka.

Eksperte Kontabel e Autorizuar

Nr. License 121

**Lumturi BRAHAJ**



